



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1576/2 Prot.

Tiranë, më 21.12.2021

V E N D I M

Nr. 248, Datë 21.12.2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 210, datë 16.11.2021, të paraqitur nga znj. M.L kundër Ministres së Kulturës, znj. Elva Margariti, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*hakmarrjes personale*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja M.L deklaron se ka qenë e punësuar në pozicionin Drejtor e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, nga data 24.12.2014 deri më 20.10.2021. Ankuesja shprehet se, pas një sage përndjekjeje personale dhe të qëllimshme mbi dy vjeçare, që nga shkurti 2019 e në vazhdim, nga ana e Ministres së Kulturës, znj. Elva Margariti, për largimin e saj nga puna, sulme të cilat kanë qenë të vazhdueshme, të qëllimshme dhe diskriminuese ndaj saj, të bëjnë të kuptosh që i gjithë ky sulm diskriminues është një “hakmarrje personale” e znj. Margariti ndaj saj.

Ankuesja shpjegon se, me shkresën nr.4591 prot datë 08.09.2021, ardhur në *emailin* zyrtar të DRTK Shkodër¹, duke anashkaluar qëllimisht njoftimin e saj, është njoftuar nga punonjësit e këtij institucioni me telefon, për fillimin e procedurës për shpalljen e konkurimit për pozicionin Drejtor, në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, në një kohë kur ajo ishte me raport mjekësor dhe stafi i Ministrisë së Kulturës ishte në dijeni të plotë të këtij fakti. Ankuesja shprehet se pavarësisht ankimeve të saj mbi procesin dhe procedurën e gabuar të ndjekur, Ministria e Kulturës vazhdoi procedurën e konkurimit në shkelje të plotë të Kodit të Punës, konkretisht nenit 147. Sipas ankueses procesi i konkurimit për këtë pozicion pune është nul, pasi ajo ka afërsisht 7 vite punë në atë pozicion dhe është riemëruar në detyrë me urdhrin nr.433 prot., datë 29.06.2017, të Ministrit të Kulturës.

¹ Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër.

Më datë 29.10.2021, ankuesja shpjegon se, përmes *emailit*, është njoftuar nga DRTK Shkodër për t'u paraqitur dhe për të bërë dorëzimin e detyrës, sipas urdhrit nr.685 prot datë 20.10.2021. Ankuesja pretendon se nuk është vënë në dijeni zyrtarisht për këtë urdhër dhe akoma deri në datë 12.11.2021, nuk ka marrë asnjë njoftim ose komunikim zyrtar ose me postë elektronike, dhe as në banesën e saj të banimit, sikurse citohet në këtë urdhër.

Ankuesja thekson se sa më sipër i është komunikuar vetëm me *email* nga punonjësit e DRTK Shkodër dhe jo në adresën e saj të banimit, pasi ajo ka qenë me raport mjekësor. Të gjitha këto veprime dhe mosveprime sipas ankuses janë diskriminuese dhe në shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 4, 6 dhe 17. Ajo pretendon se i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar nga punëdhënësi dhe nuk është respektuar afati 3 mujor i njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, pasi ka mbi 5 vite punë.

Ankuesja shpjegon se, pak ditë pas emërimit në detyrë të ministres znj. Margariti, ka ndodhur një komunikim në grup në *whatsapp*, mbi një proces ndërtimi të paligjshëm në zonën arkeologjike A, pranë Bashkisë Lezhë, e cila po kryhej nga kjo e fundit. Ankuesja shprehet se ka ndjekur të gjithë procedurën e parashikuar nga ligji për trashëgiminë kulturore, duke njoftuar institucionet përgjegjëse për marrjen e masave të menjëhershme, procedurë e cila sipas saj, ra në vesh të shurdhër. Gjatë komunikimit të asaj dite në *whatsapp*, ankuesja deklaroi se është akuzuar nga znj. Margariti, për moskryerjen e detyrës, pa marrë fare parasysh procedurën e ndjekur prej saj deri në atë moment, duke e diskriminuar publikisht para kolegëve në aspektin profesional.

Sipas ankuses, kjo mënyrë komunikimi diskriminuese ka vijuar edhe në rastin e tërmetit të shtatorit 2019. Ankuesja shpjegon se, pavarësisht se në Shkodër lëkundjet sizmike nuk u ndjenë shumë, institucioni që ajo drejtonte kishte dërguar raportin e situatës pranë Ministrisë së Kulturës, ku kishin sqaruar se nuk kishte dëme në objektet me status monument kulture. Në *whatsapp*, ku ishte grupi i krijuar nga ministria me të gjithë titullarët e institucioneve të trashëgimisë dhe kabinetin e ministres, kjo e fundit, ka shkruar vetë në grup për një kishë në qendër të qytetit të Shkodrës, që kishte probleme nga tërmeti dhe për të cilën ankuesja nuk kishte informuar. Ndër të tjera, znj. Margariti, është shprehur se, ankuesja nuk po e realizonte punën dhe kishte papërgjegjshmëri në punë. Sipas ankuses, kisha për të cilën ishte akuzuar për papërgjegjshmëri ishte Kisha e Shën Palit në Tiranë, që nuk përfshihet në territorin që administron DRTK Shkodër. Ankuesja shprehet se këtë informacion e ka ndarë në grupin e komunikimit të *whatsapp* dhe që nga ky moment e në vazhdim ajo shprehet se sulmet nga ana e ministres ndaj saj nuk kanë ndalur.

Ankuesja shpjegon se edhe gjatë vitit 2020, një vit i vështirë për të gjithë për shkak të pandemisë, edhe pse ishte me covid 19, sulmet kundër saj nuk kanë rreshur, pasi znj. Margariti kërkonte vazhdimisht që të bënte mbledhje për çështje pune edhe pse e dinte që ajo po kalonte covid, pasi i kishte vendosur në dispozicion të gjitha analizat nëpërmjet komunikimeve me *email*.

Në mars 2021, ankuesja shprehet se është urdhëruar me porosi të ministres të punësonte një person, por ajo konform ligjit kishte hapur procedurën e konkurimit për vendin provizor dhe vendi i punës fitohet nga një tjetër person. Pas këtij momenti, ankuesja deklaron se ministrja e ka akuzuar se ka bërë punësim në kohë zgjedhjesh. Ajo sqaron se, për rastin e punësimit në Kodin Zgjedhor parathuhet se quhen raste të ligjëruara emërimet në punë kur këto emëime bëhen brenda strukturës dhe organikës së miratuar para fushatës zgjedhore. Pavarësisht se ligji e thotë qartë, kjo gjë nuk u mor parasysh, sepse nuk ishte punësuar e preferuara e ministres. Që nga ky moment ankuesja pretendon se diskriminimi ndaj saj mori edhe më shumë hov dhe filloi ta pësojë edhe institucioni, pasi ministrja me qëllim vononte miratimin e autorizimit për fillimin e procedurave të prokurimit publik për mirëmbajtjen e objekteve. Këtë vit, sipas ankueses në qarqet që mbulohen nga DRTK Shkodër nuk është bërë asnjë mirëmbajtje në objektet e trashëgimisë kulturore, si asnjëherë më parë, pasi ndërhyrjet mirëmbajtëse janë jetike për qëndrueshmërinë e tyre. Sipas ankueses, ky nuk është vetëm diskriminim ndaj saj, por një shpërdorim flagrant i detyrës dhe shkatërrim i pasurisë kombëtare.

Në korrik 2021, ankuesja deklaron se ka filluar një procedurë absurde lidhur me vijimësinë e marrëdhënies së punës, duke vazhduar hakmarrjen personale, ndërkohë që ajo ishte në kushte jo të mira shëndetësore, situatë për të cilën ministra ishte në dijeni. Në shtator, vijohet me një tjetër lëvizje hakmarrëse dhe totalisht në shkelje të ligjit, me shpalljen e konkurimit të hapur publik për pozicionin e punës të mbajtur nga ankuesja, pavarësisht se kjo e fundit ishte me raport mjekësor.

Sipas ankueses, për të çuar deri në fund hakmarrjen personale, znj. Margariti, stiste shkaqe për largimin e saj nga puna. Në shtator 2021, konstatoi emërimin e ankueses të bërë me shkresën nr. 378 prot., datë 24.12.2014, i cili është ligjerisht nul, pasi institucioni bazohet tek Kodi i Punës dhe ankuesja ka afërsisht 7 vite punë dhe qëllimisht është anashkaluar urdhri i vitit 2017 (shkresa nr. 433 prot., datë 29.06.2017). Ankuesja thekson se, të gjitha këto sulme, përbëjnë diskriminim dhe hakmarrje personale ndaj saj, dhe kanë shkaktuar tek ajo pasoja të rënda shëndetësore.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri pranimin e ankimit të saj dhe konstatimin e diskriminimit për shkak të gjëndjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër.

- Me e-mail datë 22.11.2021, ankuesja ka përcjellë pranë Komisionerit informacione shtesë në lidhje me ankesën, duke parashtruar ndër të tjera se:

Për një periudhë 4 vjeçare, ankuesja pretendon se nga ana e Ministres së Kulturës znj. Margariti, nuk i janë miratuar lejet e zakonshme për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Këto fakte ankuesja i lidh me pretendimin për diskriminim për shkak të “hakmarrjes personale”. Në lidhje me këtë pretendim ankuesja shprehet se ka bërë kërkesë pranë DRTK Shkodër, për t’i vënë në dispozicion orët e punës dhe lejet për periudhën 2018-2021 dhe të gjitha faktet do t’i përcjellë sapo t’i vendosen në dispozicion.

Ankuesja pretendon gjithashtu se, është duke u diskriminuar nga ana e DRTK Shkodër e cila nuk respekton shkresën nr.5466/1 prot., datë 21.10.2021, duke mos i garantuar të drejtat financiare që rrjedhin nga përfundimi i marrëdhënies së punës me këtë institucion.

- Me anë të *e-mail* datë 25.11.2021, ankueses i është kërkuar informacion shtesë në lidhje me shkaqet e pretenduara prej saj. Në vijim të kësaj kërkesë, ankuesja dërgoi me *e-mail* datë 01.12.2021, informacionin shtesë të kërkuar, duke informuar Komisionerin se:

Në lidhje me shkakun e “gjendjes shëndetësore” ankuesja sqaron se, është ndier e diskriminuar për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, sepse i është mohuar e drejta e parimit të ligjshmërisë. Duke qenë e sëmurë, nuk ka pasur mundësi objektive që të ballafaqohet dhe trajtimi i diferencuar i është bërë thjesht duke i mohuar mundësinë (edhe pse sipas ankueses, procesi i konkurimit dhe e gjithë procedura e ndjekur ishte në kundërshtim me ligjin) e konkurimit për pozicionin e punës. Gjithashtu, ankuesja shprehet se, i kanë mohuar mundësinë që të ofron Kodi i Punës, në të cilin është dukshëm i qartë fakti se, nuk mundet të fillohet procedurë për lirim nga detyra kur je i sëmurë apo me raportë paaftësie në punë, madje edhe nëse ka filluar procedura e zgjidhjes kontraktuale, pezullohet deri në momentin që punëmarrësi kthehet në punë. Pra, kjo e drejtë e mundësuar nga ligji i është mohuar.

Në lidhje me shkakun “çdo shkak tjetër”/“hakmarrje personale”, ankuesja shprehet se, janë shumë momente, duke referuar në ngjarjet për të cilat është dhënë informacion edhe në ankesë, sikurse janë, rasti i komunikimit në grupin *whatsapp* në lidhje me objektin e ndodhur në Bashkinë Lezhë, rastin e tërmetit të shtatorit 2019, rastin e marsit 2021 në lidhje me punësimin e një personi, si dhe pretendimi për mosmiratimin e lejes së zakonshme për tre vite rresht.

Ankuesja thekson se kjo është një hakmarrje e pastër e Ministres së Kulturës ndaj saj, për ta larguar nga puna, pasi ajo nuk ishte bërë pjesë e makinacioneve të saj, por sulmet e padrejta dhe të qëllimshme i ka përballuar me dinjitet dhe profesionalizëm, fakt që ministres nuk i ka pëlqyer, pasi dëshiron pranë vetes njerëz që mund t’i komandojë lehtë dhe t’i ketë marionetë në duart e saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Mbështetur në aktet e administruara rezulton se, në urdhrin nr. 378, datë 24.12.2014 të Ministrit të Kulturës, ankuesja M.L është emëruar në detyrën e Drejtores së Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Shkodër. Referuar pikës 1, të urdhrin të sipërcituar, ankuesja është emëruar në këtë pozicion pune deri në përfundimin e procedurave të konkurimit publik. Bazuar në urdhrin nr. 277 datë 03.05.2017, të Ministrit të Kulturës, ankuesja është pezulluar nga kjo detyrë, për periudhën zgjedhore, gjatë zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017, dhe është rikthyer në të njëjtin pozicion pune, me urdhrin nr.433, datë 29.06.2017, të Ministrit të Kulturës.

Nga aktet e administruara rezulton se, me shkresën nr. 4591 prot., datë 08.09.2021, Ministria e Kulturës, ka njoftuar znj. M.L, se bazuar në pikën 1, të urdhrin nr. 378, datë 24.12.2014 të Ministrit të Kulturës, ministria do të fillonte procedurën e shpalljes për konkurim, për pozicionin Drejtor, në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër. Në këtë shkresë, sqarohet se marrëdhënia e punës së ankueses sipas përcaktimit të urdhrin të mësipërm, do të ishte e vlefshme

deri në përfundimin e procedurës së konkurimit publik. Kundër këtij njoftimi, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Ministrisë së Kulturës, duke pretenduar se procedura e hapur për konkurimin publik ishte e pavlefshme dhe në kundërshtim me ligjin dhe ka kërkuar anulimin e saj. Me shkresën nr. 4898/1 prot., datë 30.09.2021, Ministria e Kulturës, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke u shprehur se marrëdhënia e punës së ankueses si titullare e DRTK Shkodër është krijuar në bazë të urdhërit nr. 378, datë 24.12.2014, i cili në pikën 1 të tij, parashikon se marrëdhënia e punës do të jetë e vlefshme deri në përfundimin e procedurës së konkurimit për pozicionin e titullarit të institucionit. Ky urdhër nuk është shfuqizuar në asnjë moment, por ka qenë dhe vazhdon të jetë në fuqi. Edhe kundër kësaj përgjigje, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Ministrisë së Kulturës, duke pretenduar paligjshmërinë e procedurës së ndjekur nga ky institucion. Me urdhrin nr. 685, datë 20.10.2021, të Ministrit të Kulturës është vendosur lirimi nga detyra i znj.M.L, nga detyra e Drejtorit të përkohshëm të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, në Shkodër. Ky urdhër i është komunikuar për njohje dhe zbatim Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, me shkresën nr. 5466/1 prot., datë 21.10.2021. Sipas pretendimeve të ankueses, ajo ka marrë dijeni për urdhrin e liritimit nga detyra në datë 29.10.2021, përmes *emailit*, të dërguar nga DRTK Shkodër, për t'u paraqitur dhe për të bërë dorëzimin e detyrës, sipas urdhrit nr. 685 prot., datë 20.10.2021.

Ankuesja ka depozituar ankesën pranë Komisionerit duke pretenduar se është diskriminuar duke u larguar nga puna për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “hakmarrjes personale” të Ministres së Kulturës, znj. Elva Margariti.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” dhe “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se : “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllorja për individë ose

kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminim” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme. Mbrojtja nga diskriminimi sipas KEDNJ dhe Protokollit 12-të saj, garantohet bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore, të pretenduar nga ankuesja, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtëpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup

tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standartet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se:

- Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”

Nga aktet e administruara rezulton e provuar se, për shkak të gjendjes shëndetësore ankuesja ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë, duke filluar nga data 21.07.2021 deri në datën 30.07.2021, që është raporti i parë mjekësor, për të vijuar më tej me raportet mjekësore për periudhat: 03.08.2021-08.08.2021; 09.08.2021-24.08.2021; 07.09.2021-21.09.2021; 21.09.2021-06.10.2021; 06.10.2021-21.10.2021; 21.10.2021-05.11.2021.

Bazuar në informacionin e administruar dhe shpjegimet që ankuesja jep në lidhje me këtë shkak, nuk rezulton që gjendja shëndetësore e ankueses të ketë shërbyer si shkak ose si motivacion për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Pretendimi ankueses për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore konsiston në dy momente. Momenti i parë ka të bëjë me pretendimin e ankueses se nuk mund të fillohet një procedurë për lirim nga detyra gjatë kohës që punëmarrësi është me raport mjekësor dhe nëse ka filluar një procedurë e tillë ajo duhet të pezullohet. Ankuesja pretendon se gjatë kohës që ajo ka qenë me raport mjekësor, Ministria e Kulturës ka filluar dhe

ka finalizuar procedurën e lirim të saj nga detyra, veprim ky që vjen në kundërshtim me nenin 147 të Kodit të Punës.

Bazuar në nenin 147, të Kodit të Punës, parashikohet zgjidhja e kontratës në kohë të papërshtatshme. Në këtë dispozitë sanksionohet si vijon: *“1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi. 2. Kur zgjidhja e kontratës bëhet para se punëmarrësi të jetë me paaftësi të përkohshme në punë ose të jetë me pushime të dhëna nga punëdhënësi dhe afati i njoftimit nuk ka përfunduar, ky afat pezullohet për periudhën e kryerjes së shërbimit ushtarak, të paaftësisë së përkohshme në punë ose të pushimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe rifillon pas përfundimit të kësaj periudhe.”*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses për zgjidhjen e kontratës në kohë të papërshtatshme dhe shkelje të nenit 147 të Kodit të Punës është një pretendim i cili bie jashtë konceptit të diskriminimit. Një pretendim i tillë është një situatë e ndryshme ligjore nga pretendimi për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe për rrjedhojë është jashtë kompetencave të Komisionerit. Në rastin konkret, ankuesja nuk ka parashtruar asnjë pretendim se gjendja e saj shëndetësore ka shërbyer si shkak ose si bazë për zgjidhjen e kontratës së punës dhe pretendimi se zgjidhja e kontratës është bërë gjatë kohës që ankuesja ka qenë me raport mjekësor, por që në thelb pretendohet se ka një shkak tjetër dhe jo gjendjen shëndetësore, nuk përlligj kërkimin e ankeses për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Për shkeljen e ndalimit të vendosur nga neni 147 i Kodit të Punës, ankuesja duhet t'i drejtohet gjykatës, si autoriteti kompetent për të gjykuar në lidhje me pretendimin e saj.

Momenti i dytë ka të bëjë me pretendimin e ankueses se, për shkak të gjendjes shëndetësore, i është mohuar mundësia e konkurimit për pozicionin e punës, edhe pse procesi i konukrimit dhe e gjithë procedura e ndjekur, sipas saj, është në kundërshtim me ligjin. Komisioneri vlerëson se, një pretendim i tillë nuk është i bazuar. Komisioneri nuk vlerëson ligjshmërinë e procedurës së konkurimit të shpallur nga Ministria e Kulturës, por vlerëson se kjo e fundit, në cilësinë e punëdhënësit që ka realizuar shpalljen për vendin e punës, të konsideruar si vend i lirë, nuk mund ngarkohet me detyrimin që në përcaktimin e ditës së konkurimit të garantojë që të gjithë kandidatët e interesuar të mos kenë pengesa që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore, si në rastin e ankueses.

Sa më sipër është arsyetuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimi i ankueses për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore është i papajtueshëm me dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar dhe njëkohësisht haptazi i bazuar.

- Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “hakmarrjes personale”

Bazuar në legjislacionin në fuqi, mbrojtja nga diskriminimi garantohej bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, fakt ky që rezultoi nga përfshirja e shprehjes “për çdo shkak tjetër”, të parashikuar nga neni 1, i ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Ankuesja pretendon diskriminim në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, duke pretenduar se largimi i saj nga puna ka ndodhur për shkak të “hakmarrjes personale”, të Ministres së Kulturës znj. Elva Margariti kundër saj, pasi ajo nuk u bë pjesë e makinacioneve të ministres.

Për të vlerësuar nëse pretendimet e ankueses në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit dhe nëse ai gëzon mbrojtje nga parashikimi “çdo shkak tjetër”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut², në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera, sipas nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut³. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “status”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri⁴. Gjykata ka theksuar se fjalës “shkak/status tjetër” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.⁵ Gjykata fillimisht vëren që, ndërsa një numër i shembujve konkretë kanë të bëjnë me karakteristikat që mund të thuhet se janë “personale” në kuptimin që ato janë karakteristika të lindura ose të lidhura natyrshëm me identitetin ose personalitetin e individit, të tilla si seksi, raca dhe feja, jo të gjitha shkaqet e listuara mund të karakterizohen kështu.

Ankuesja deklaroi se, arsyet e “hakmarrjes personale” janë shumë momente, të cilat tregojnë se largimi i saj nga puna ka ndodhur, pasi ajo nuk u bë pjesë e makinacioneve të Ministres së Kulturës. Komisioneri vlerëson se, “hakmarrja personale” e pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues, në thelb, përbën veprimet ose mosveprimet e Ministres së Kulturës, të cilat ankuesja i kundërshton si sjellje diskriminuese, pra pasojat e padrejta që ankuesja pretendon se i kanë ardhur. Bazuar në shpjegimet e ankueses mbi arsyet e hakmarrjes së pretenduar dhe informacionin e administruar, Komisioneri nuk konstaton asnjë karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “status”, që ka shërbyer si bazë për veprimet hakmarrëse të Ministres së Kulturës, sikurse pretendohet nga ankuesja.

Duke mbajtur në konsideratë standartin e mësipërm, Komisioneri vlerëson se, shkakun “hakmarrje personale”, i pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues, nuk përbën shkak të mbrojtur, në kuadër të përcaktimit “për çdo shkak tjetër”, sipas parashikimit të nenit 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën GJEDNJ.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën KEDNJ.

⁴ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70.

⁵ Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

Komisioneri vlerëson se, në thelb ankuesja ka ngritur pretendime për paligjshmëri të veprimeve nga Ministria e Kulturës. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Në lidhje me paligjshmërinë e pretenduar të veprimeve dhe mosveprimeve nga ana e Ministrisë së Kulturës, ankuesja duhet t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Sa më sipër është arsyetuar, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses për diskriminim për shkak të “hakmarrjes personale” është i papajtueshëm me dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesja M.L kundër Ministres së Kulturës, znj. Elva Margariti, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe haptazi e pabazuar, dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe “ç” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 210 regj., datë 16.11.2021, të paraqitur nga ankuesja M.L kundër Ministres së Kulturës, znj. Elva Margariti.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shëndetësore, Hakmarrje personale
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim